

Sesion informues

Forcimi i kapaciteteve dhe ndikimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në mirë-qeverisje dhe luftën kundër korrupsionit në nivelet e qeverisjes vendore

Tiranë, 29 janar 2016

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka përzgjedhur për të financuar dy projekte të cilat synojnë të rrisin kapacitetet e shoqërisë civile me qëllim promovimin e mirë-qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit në nivelet e qeverisjes vendore. Projektet e financuara në kuadër të programit IPA 2014/2015 “Instrumente për Shoqërinë Civile – Iniciativat Civile dhe Rritja e Kapaciteteve, Shqipëri do të implementohen nga dy konsorciume të drejtuara respektivisht nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC).

Gjatë periudhës së tyre të implementimit 2016-2018, këto projekte do të mbështesin organizatat e shoqërisë civile në zhvillimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet grant-dhënies me qëllim realizimin e propozimeve të cilat synojnë promovimin e mirë-qeverisjes, transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në nivelet e qeverisjes vendore.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Qendra Kombëtare Shqiptare për Trajnim dhe Asistencë Teknike kanë kënaqësinë të ftojnë organizatat e shoqërisë civile, institucionet shtetërore, donatorët dhe aktorë të tjerë përfitues (media dhe institucionet akademike) të marrin pjesë në aktivitetin prezantues të dy projekteve CIVILISC dhe PACT. Në këtë takim do të prezantohen objektivat e projekteve, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme me qëllim nxitjen e promovimit të mirë-qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit.

***Projekti: CIVILISC** – Instrumentet e Shoqërisë Civile në luftën kundër korrupsionit do të implementohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Fondacionin bullgar “Risk Monitor” në 20 bashki të vogla e të mesme të vendit.*

***Projekti: PACT**- Partneritet në luftën kundër korrupsionit do të implementohet nga një konsorcium organizatash drejtuar nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike, në partneritet me Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF) dhe Qendra Vepra për Shoqërinë në 15 bashki të zonës veriore të vendit.*



AXHENDA

(29 JANAR 2016, ora 10:00-12:00, Hotel Tirana International, salla “Abret”)

09: 45 – 10: 00	Regjistrimi i pjesëmarrësve
10:00 – 10: 10	Fjalë hyrëse, Sotiraq Hroni , Drejtues ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
10:10 – 10: 20	Yngve Engstroem , Shef i Operimeve, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
10: 20 – 10: 30	Gentian Elezi , Zv. Ministër- Ministria e Integritimit Evropian
10:30 – 10: 40	Erisa Proko , Këshilltare e Ministrit për Çështjet Vendore
10: 40 – 10: 50	Andi Kananaj , Drejtor i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë
10: 50 – 11:00	Myftar Doci (ANTTARC) – Prezantimi i projektit PACT
11:00 – 11: 10	Dalina Jashari (IDM) – Prezantimi i projektit CIVILISC
11: 10- 11:50	Pyetje dhe komente nga pjesëmarrësit
11: 50 – 12: 00	Konkluzione- Myftar Doci, ANTTARC
12:00	Koktejl

